



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**NR. 22/9 DATË 18 / 07 / 2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E  
VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “RESORT TURISTIK ME  
VENDNDODHJE NË GJIRIN E LALËZIT”, ME SUBJEKT “OMNIX ALBANIA”  
SH.P.K. NUIS K81527005D**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 22, 24, 27 dhe 29 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

**VLERËSOI:**

- Projekti konsiston në një kompleks luksoz që përfshin një park rezidencial, një bulevard, një hotel me 5 yje, park ujqor, klub fëmijësh, klub plazhi etj.
- Vlera e investimit të projektit të investimit “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit” i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë rreth 216,000,000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion) Euro.
- Projekti i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike, duke parashikuar të punësojë rreth 252 (dyqind e pesëdhjetë e dy) persona.
- Subjekti ka paraqitur gjithashtu “Letër Interesi” lëshuar nga International Hotels &

Resorts Group, një nga kompanitë më të mëdha ndërkombëtare në fushën e mikpritjes, që zotëron 17 nga brandet kryesore në sektorin e akomodimit.

- Subjekti aplikues propozon zhvillimin e një investimi në bregdetin e Gjirit të Lalëzit, pranë Draç Durrës. Projekti prek një sipërfaqe prej 145,400 m<sup>2</sup> në pronësi të subjektit aplikues (respektivisht parcela me nr. pasurie 178/41, lloji i pasurisë Pyll, në ZK 1522; parcela me nr. pasurie 178/39, lloji i pasurisë Pyll, në ZK 1522; parcela me nr. pasurie 181, lloji i pasurisë Pyll në ZK 1522), gjithashtu një sipërfaqe prej 92,225 m<sup>2</sup> në pronësi shtet dhe 81,000 m<sup>2</sup> plazh. Nga sipërfaqja e lart përmendur që prek projekti, kërkohet të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor 60,000 m<sup>2</sup> e cila është sipërfaqe e truallit e zënë nga gjurma. Kjo sipërfaqe prej 60,000 m<sup>2</sup> është e ndarë në pasuritë pronë shtetërore me sipërfaqe 15,800 m<sup>2</sup> dhe pasuritë pronë private në pronësi të “Omnix Albania” sh.p.k. sipërfaqja 44,200 m<sup>2</sup>.
- Projekti ka leje ndërtimi nga KKT me Vendim Nr. 10 datë 28.07.2016.
- Në zonën e zhvillimit të projektit, ndodhet një sipërfaqe trualli dhe fondi pyjor, në pronësi shtet, pjesë e ngastrës nr. 70 abcd, e cila i është dhënë me qira shoqërisë nëpërmjet kontrate qiraje e vitit 2011 me palë “Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës” dhe Shoqëria “Omnix Albania” sh.p.k. për dhënie në përdorim sipërfaqen 28,018 ha për përdorim dhe sipërfaqe për rrugë kalimi. Afati 10 vjeçar ka përfunduar datë 20.05.2021. Kontrata është rinovuar automatikisht.
- Nëpërmjet VKM nr. 585, datë 13.07.2016, është parashikuar që sipërfaqja pyjore prej 28,018 ha, në ngastrat nr. 70 abcd të ekonomisë pyjore “Rrotull”, që do të përdoret nga shoqëria "Omnix Albania" sh.p.k. për ndërtimin e kompleksit turistik, të hiqet nga fondi pyjor dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Aktualisht rezulton që ky proces, për pasurinë nr. 178/44, pasurinë nr. 182 dhe pasurinë nr. 152/43 në ZK nr. 1522 nuk është kryer nga institucionet e ngarkuara në vendim dhe masa mbështetëse që kërkohet nga subjekti është zbatimi i këtij vendimi nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin. Meqenëse gjurma do të përdoret për ndërtimin e një kompleksi turistik rezidencial, subjekti propozon në aplikimin për status që sipërfaqet pyjore dhe kullësore, të azhurnuara, që do të hiqen nga fondi pyjor dhe kullësor dhe që

janë pronë publike e shtetit, sipas kartelave të pasurisë së paluajtshme, të regjistruhen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë "Omnix Albania" sh.p.k., kërkesë kjo e arsyetuar edhe referuar parashikimeve të VKM Nr. 704, datë 18.11.2021.

- Pas miratimit të VKM Nr. 585/2016, një pjesë e sipërfaqes shtet i është kthyer ish-pronarit privat, e cila është reflektuar në kadastër. Në këtë sipërfaqe, shoqëria "Omnix Albania" sh.p.k. nuk ka asnjë pretendim mbi zhvillimin dhe nuk kërkon të jetë pjesë e zonës së projektit.

Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të projektit, rezultoi gjithashtu se sipërfaqja e dhënë me qira sipas kontratës së qirasë të vitit 2011 me palë "Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës" dhe Shoqëria "Omnix Albania" shpk, nuk përputhet me sipërfaqen që parashikon VKM Nr. 585, datë 13.07.2016. Për pasojë duhet azhurnuar sipërfaqja shtet në këto akte dhe miratimi i dokumenteve ligjor përkatës që sigurojnë konsolidimin e pronës në të cilën zhvillohet projekti.

- Subjekti aplikues ka rishikuar gjurmën e zhvillimit të projektit ashtu si dhe gjurmën e vijës bregdetare në funksion të tij, e cila gjendet në Aneks 1 të këtij vendimi, ku rezultojnë sipërfaqet: 145,400 m<sup>2</sup> në pronësi të "Omnix Albania" sh.p.k., sipërfaqe 92,225 m<sup>2</sup> në pronësi shtet.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vlerëson se nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier", i ndryshuar, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të saj disa pasuri shtetërore në vijën bregdetare "Shkodër-Fier". Bazuar në përcaktimet e VKM Nr. 585/2016, për pasurinë/pasuritë që përkojnë me këtë vendim, rezulton që nuk bëjnë pjesë në pasuritë që kanë kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet VKM nr. 707/2018.
- Ministria përgjegjëse për turizmin vlerëson gjithashtu se subjekti ka vënë në dispozicion planvendosjen me koordinatat e pronave ku do të zhvillohet projekti, të pandara nga zona e brigjeve që investitori kërkon të përfitojë si masë mbështetëse. Këto koordinata, sipas ndarjes së stacioneve të plazhit të vitit 2021, përkojnë me parcelën me Kod "DR-33", e cila është parcelë publike.
- Bashkia Durrës vlerëson se projekti nuk parashikohet si objektiv strategjik i Vlerësimit

Strategjik Mjedisor i PPV-së pasi duhet t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis bazuar në pikën 11/c sipas Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011. Gjithashtu nuk është pjesë e Vendimit Nr. 507, datë 10.06.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor". PPV e Bashkisë Durrës është miratuar me vendim Nr. 1, datë 15.04.2021 dhe është në proces zbardhjeje.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë" për projektin e investimit "Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit". me subjekt "Omnix Albania" sh.p.k. me NUIS K81527005D.
2. Projekti i investimit strategjik "Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit" do të zhvillohet nga subjekti "Omnix Albania" sh.p.k. NUIS K81527005D.
3. Projekti i investimit strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.
4. Projekti i investimit strategjik do të zhvillohet në ZK 1522, në parcelat me nr.pasurie: 178/39, 181, 178/41, 178/44, 182 dhe 152/43.
5. Projekti konsiston në realizimin e një kompleksi luksoz, që përfshin një park rezidencial, një bulevard, një hotel me 5 yje, park ujqor, klub fëmijësh, klub plazhi etj.
6. Statusi "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë" i jepet projektit të investimit "Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, bregut të detit dhe zonës përballë plazhit, të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave, pas saktësimit të koordinatave dhe sipërfaqeve respektive me Agjencinë Kombëtare të

Pyjeve dhe Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

7. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, neni 22, neni 27 dhe neni 29 i Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit të investimit strategjik janë si më poshtë:

- a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
- b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
- c) Miratohet në parim masa mbështetëse konsolidim toke si dhe dhënia e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqes prej 90 030 m<sup>2</sup> të fondit pyjor kullosor, me pronësi Republika e Shqipërisë.
- ç) Miratohet të hiqet nga sipërfaqja pyjore kullosore prej 60,000 m<sup>2</sup>, sipas legjislacionit specifik sektorial për pyjet e kullotat, referuar Aneks 1 të këtij vendimi, e ndarë si më poshtë:
  - i. 15,800 m<sup>2</sup> në pasuritë pronë shtetërore me nr parcele 182; 152/43 dhe 178/44; dhe
  - ii. 44,200 m<sup>2</sup> në pasuritë pronë private, në pronësi të Shoqërisë “Omnix” Albania” shpk, me nr parcele 181; 178/39 dhe 178/41.

Në zbatim të nenit 27 të Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme, kryhet pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me afat 99 vjet, nëpërmjet kontratës simbolike 1 euro, për projekte investuese, konkretisht projektit të investimit “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit”, pasi të bëhen verifikimet e nevojshme të pronës nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, sipas koordinatave të dhëna nga investitori.

8. Në zbatim të nenit 29 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, miratohet vetëm me vendim të veçantë nga Këshilli i Ministrave, me propozim nga Komiteti i Investimeve Strategjike, pas marrjes së mendimit paraprak nga institucionet, kompetencat e të cilave shtrihen në këto zona. Miratimi përfundimtar, planvendosja e vijës bregdetare sipas stacioneve të miratuara të plazhit dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik, do të përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, pasi të jenë konfirmuar këto koordinata nga institucionet e përfshira në vlerësim, por në asnjë rast me afat më të gjatë se 30 vite.
9. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen në planin e veprimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
10. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit strategjik “Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
11. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për finalizimin e kalimit dhe regjistrimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse të turizmit, të sipërfaqes prej 90 030 m<sup>2</sup>, ZK 1522, nr.pasurie: 178/44, 152/43 dhe 182, në zonën me përparësi zhvillimin e turizmit dhe vënien në dispozicion të kësaj sipërfaqe për realizimin e projektit të investimit strategjik në përputhje me legjislacionin në fuqi për turizmin.
12. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për heqjen e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe prej 60,000 m<sup>2</sup> pjesë e ngastrës 70 abcd të ekonomisë pyjore “Rrotull”, sipas Aneks 1 të këtij vendimi, nga fondi pyjor kullosor sipas legjislacionit specifik sektorial për pyjet dhe çregjistrimin nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor dhe të infrastrukturës së saj të paguhen nga subjekti aplikues sipas legjislacionit në fuqi.

13. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe subjekti aplikues të hartojnë marrëveshje të përbashkët lidhur me pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër.
14. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit që sipërfaqet e azhurnuara pronë publike e shtetit, sipas kartelave të pasurisë së paluajtshme, që preken nga ky projekt, në referencë të legjislacionit të turizmit e përkatësisht dispozitave për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, të regjistrohen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin dhe vënien e saj në dispozicion për realizimin e projektit të investimit strategjik, në zbatim të legjislacionit në fuqi për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.
15. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pasi të bëjë verifikimin e koordinatave të brigjeve të detit si dhe të zonës përkatëse të plazhit, sipas Aneks 1 të këtij vendimi, të propozojë në Këshillin e Ministrave Vendimin “Për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik.
16. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet e nevojshme në regjistrin kadastral.
17. Ngarkohet Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për përshtatjen e njësive strukturore sipas treguesve të rinj të miratuar, referuar projektit të investimit strategjik në fjalë.
18. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e Planit të Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
19. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
20. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

ARBEN AHMETAJ

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

DELINA IBRAHIMAJ

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFCA

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

SOKOL NANO



## **PLANI I VEPRIMIT**

### **PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK "RESORT TURISTIK ME VENDNDODHJE NË GJIRIN E LALËZIT", ME SUBJEKT "OMNIX ALBANIA" SH.P.K. NUIS K81527005D**

#### ***1) Përmbajtja e planit të veprimit***

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

#### ***1. Zbatimi i planit të veprimit***

Plani i veprimit monitorohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### ***2. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit "Resort Turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit"***

Ky plan veprimi për realizimin e këtij projekti investimi, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe

zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

### ***3. Hapat procedurale***

Propozimi nga investitori:

Investitori "Omnix Albania" sh.p.k., kur paraqiti projektin e investimit tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e tij.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

<b>Masat e kërkuara</b>	<b>Rekomandimi</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse</b>	<b>Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti</b>	<b>Afati</b>	<b>Kosto</b>
-------------------------	--------------------	--------------------------------	---	---	--------------	--------------

<p>Zbatim i angazhimeve të ndërmarra nga qeveria nëpërmjet VKM 585/2016.</p> <p>Konsolidim prone, azhurnim i të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme shtet që preken nga projekti i investimit, heqje nga fondi pyjor dhe vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtet për zhvillimin e investimit.</p>	<p>PO</p> <p>Të përcaktohen qartazi kufijtë e pronës shtetërore;</p> <p>Parcelat të kalojnë në përgjegjësi administrimi të MTM</p> <p>Të lidhet kontratë me subjektin sipas legjislacionit të turizmit për zonat me përparësi zhvillimi.</p> <p>Sipërfaqe prej 60,000 m2 të hiqet nga fondi pyjor dhe të nënshkruhet një marrëveshje tjetër me subjektin për zëvendësimin e sipërfaqes pyjore.</p> <p>Zona ranore e bregdetit të ndahet nga pjesa tjetër e gjurmës dhe bregu i detit së bashku me</p>	<p><b>MTM</b></p> <p><b>ASHK</b></p> <p><b>AIDA</b></p> <p><b>MTM</b></p> <p><b>ASHK</b></p> <p><b>MTM</b></p> <p><b>AKB</b></p> <p><b>Bashkia</b></p> <p><b>Durrës</b></p> <p><b>AIDA</b></p> <p><b>MTM</b></p> <p><b>ASHK</b></p> <p><b>MTM</b></p> <p><b>Bashkia</b></p> <p><b>Durrës</b></p> <p><b>ASHK</b></p>	<p>Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të lidhur kontratën e qirasë 1 Euro me subjektin, në zbatim të legjislacionit në fuqi</p>		<p>Me procedurë të përshpejtuar dhe afate sipas nenit 23 të ligjit 55/2015</p> <p>Me procedurë të përshpejtuar dhe afate sipas nenit 23 të ligjit 55/2015</p> <p>Me procedurë të përshpejtuar dhe afate sipas nenit 23 të ligjit 55/2015 dhe Ligjit 93/2015 Neni 35</p> <p>Me procedurë të përshpejtuar dhe afate sipas nenit 23 të ligjit 55/2015</p>	
--	---	---	--	--	--	--

	<p>zonën e plazhit të vihet në dispozicion nga MTM me VKM, në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 vite.</p>				<p>Me procedurë të përshpejtuar dhe afate sipas nenit 23 të ligjit 55/2015</p>	
--	---	--	--	--	--	--

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**DELINA IBRAHIMAJ**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**MIRELA KUMBARO**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**FRIDA KRIFCA**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

**ODISE MOÇKA**

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

**SOKOL NANO**